



Prishtinë, 27 shkurt 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3206_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në dispozitat e:

- Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 7 nënparagrafet 7.2, Nenit 16 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, Nenit 26 dhe Nenit 54 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;
- Nenit 27 paragrafit 6, nënparagrafit 6.5 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike;
- Nenit 4 të "Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" të datës 12 shkurt 2020, si dhe
- Shkresën e KEDS me nr 05 të dt.22.01.2026, për aprovim të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes me adresë Rr. Bill Clinton, Nr 5, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në seancën e mbajtur me datë 27 shkurt 2026, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** emërimi i z. Arben Nagavci, Zyrtar i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), i emëruar nga Bordi Ekzekutiv i OSSH-së me 21 janar 2026.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me 12 shkurt 2020 ka aprovuar Programin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes përmes vendimit V_1223_2020, ku sipas Nenit 4 të tij kërkohet që Zyrtari i Pajtueshmërisë t'i nënshtrohet miratimit nga ZRRE-ja.
- o Emërimi i Zyrtarit të Pajtueshmërisë ishte paraparë me Direktivë të Bashkimit Evropian (2009/72/EC dhe 2003/54/EC), Ligjin për Energjinë Elektrike (03/L-201 dhe Nr.05/L-085), Udhëzuesin për Shturje Ligjore të KEDS nga Furnizuesi Publik dhe poashtu në Programin e Pajtueshmërisë së OSSH-së. Sipas Nenit 27 paragrafi 6.6 t' Ligjit për Energjinë Elektrike, përveç tjerash parashihet se, citoj: *"Zyrtari i pajtueshmërisë me qëllim të kryerjes së detyrave të tij duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe duhet të ketë qasje në të gjitha informatat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të ndonjë ndërmarrje të ndërvarur të tij."*
- o Në pajtim me Programin e Pajtueshmërisë, funksionin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë së OSSH-së deri në fund të vitit 2025 e kishte ushtruar z. Avni Alidemaj, i cili kishte kontribuar në mënyrë profesionale dhe të përkushtuar në përmbushjen e detyrimeve rregullative dhe të licencës së OSSH, si dhe në pajtim me Programin e Pajtueshmërisë. Z. Alidemaj ishte emëruar nga Bordi i ZRRE-së me vendimin V_1256_2020, të dt 23 qershor 2020.
- o Duke qenë se KEDS kishte emëruar Z. Alidemaj si Zyrtar Kryesor të Operimeve të OSSH-së, KEDS përmes shkresës nr 62 e dt. 20.11.2025 kishte kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të aprovohet z.Sami Rexha në pozitën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë, e i cili po ashtu mbante edhe pozitën e sekretarit të kompanisë. Për këtë qëllim dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit si më sipër,



ZRRE ka kërkuar nga KEDS që kjo pozitë të mbulohet nga një zyrtar i cili duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe të ketë qasje në të gjitha informatat e OSSH-së.

- Bordi i drejtorëve të KEDS me datë 21 janar 2026 ka vendosur që z. Arben Nagavci ta emëroj si Zyrtar i Pajtushmërisë së KEDS SH.A dhe njëkohësisht z. Sami Rexha ta liroj nga kjo pozitë.
- KEDS përmes shkresës së 22 janar 2026 ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që Z. Arben Nagaci të emërohet si Zyrtar i Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ku për përvojën e tij ka bashkëngjitur CV-në e z. Nagavci.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas vlerësimit të shkresave të sipërcekura, CV-së së Z. Nagavci, Vendimit e dt. 21.01.2026 të Bordit të KEDS-it për emërimin të tij dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi V_1256_2020, i dt 23 qershor 2020.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KEDS dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Gani Buçaj, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar